

Propozimi

Në përputhje me nenin 29, paragrafi 3 i Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi", Nr. 55/16, 74/16, 2/18 dhe 66/19) dhe nenit 58, linja 30 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e komunave", nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në një seancë të mbajtur më _____ 2020, miratoi

V E N D I M I N
për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Bordit të Drejtorëve
SHPSH "Veprimtaritë komunale" Ulqin
numër 2216 datë 24.07.2017.

Neni 1

Pëlqimi i jepet Vendimit të Bordit të Drejtorëve të SHPK "Veprimtaritë komunale" Ulqin numër 2216 i miratuar në seancën e datës 24.07.2017, i cili vendosi që për përdoruesit e shërbimeve të shoqërisë nga kategoria e subjekteve ekonomike dhe për objektet e përkohshme me karakter sezonal, për muajin qershor dhe korrik, tarifa e rritur e faturimit veror nuk do të zbatohet siç parashikohet nga nenet 4, 5 dhe 6 të Vendimit për çmimet e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve komunale në komunën e Ulqinit numër 344 datë 24 shkurt 2017.

Neni 2

Vendimi i Bordit të Drejtorëve të SHPK "Veprimtaritë komunale" Ulqin numër 2216 datë 24.07.2017, është pjesë integrale e këtij vendimi.

Neni 3

Ky Vendim do të hyjë në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në " Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunave",

Numri: 02-
Ulqini,

KUVENDI KOMUNAL I ULCINJ
KRYETARI I KUVENDIT,
Dr. Ilir Çapuni, s.r.



✓
DOO „KOMUNALNE DJELATNOSTI” – ULCINJ
SHPK „VEPRIMTARITË KOMUNALE” – ULQIN
Br./Nr. 2216
Ulcinj/Ulqin, 24.07.2020.god/vj.

Në bazë të Urdhërit se Ministris së shëndetit të Qeverisë së Malit të Zi, për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e bartjes në vend, përhapjen dhe ndalimin e bartjes së korona virusit të ri (“Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr.066/20 e datës 06.07.2020, 067/20 e datës 07.07.2020, 067/20 e datës 07.07.2020, 068/20 e datës 08.07.2020, 073/20 e datës 21.07.2020), Urdhëri për shpalljen e epidemisë së sëmundjes ngjitëse covid 19 në shkallë të lartë epidemiologjike (“Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr.073/20 e datës 21.07.2020), nenit 22 dhe 24 Statutit SHPK “Veprimtaritë komunale” Ulqin, Bordi i drejtorave në mbledhjen, e mbajtur me date 24.07.2020 mori këtë:

V E N D I M

Për përdoruesit e shërbimeve të shoqërisë nga kategorija e subjekteve tregtare dhe për objektet e përkohshme të karakterit sezonal, për muajin qershor dhe korrik nuk do të zbatohet tarifa verore e fakturimit e parashikuar me nenin 4, 5 dhe 6 e Vendimit për çmimet e bartjes së mbeturinave komunale në territorin e Komunës së Ulqinit nr.344 e datës 24.02.2017.

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi, i cili do të zbatohet përmes organeve dhe shërbimeve kompetente të shoqërisë, të cilët kryejnë pagesën e shërbimeve.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Bazuar në urdhërin përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë të Qeverisë së Malit të Zi, një numër i madh i subjekteve afariste në territorin e Malit të Zi dhe kështu në komunën e Ulqinit, të cilat janë përdorues të shërbimeve të ofruara nga D.O.O. “Veprimtaritë komunale” Ulqin nuk kishte të ardhurat e pritura nga sezoni turistik për shkak të situatës së re të shkaktuar nga virusi korona.

Bazuar në të njëjtën gjë, dhe duke marrë parasysh të gjithë vështirësit në biznesin financiar të këtyre subjekteve ekonomike, përdoruesve të shërbimit tonë, është propozuar të mos aplikohet tarifa e verës të njëjtëve gjë për shërbimin e ofruar të shërbimeve gjatë sezonit turistik për vitin 2020.

Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe rekomandimet e organeve kompetente shtetërore dhe shoqatave ekonomike, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i drejtorave,
Kryetari,
Amir Hoilaj

